

BASHKIA TIRANË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E PROKURIMEVE ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMEVE**

Nr. prot. _____

Tiranë ____/____/2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E
ANKIMIMIT**

Data: 10.01.2025

Drejtuar: “Marketing&Distribution” sh.a, NIPT J72124001N, Autostrada Tr-Dr, Km10, Kashar, Tiranë&“Infosoft Office” shpk, NIPT J62426002Q, Autostrada Tr-Dr, Km8, Kashar, Tiranë

- OE/BOE me nënkontraktor

PO **JO**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO **JO**

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

* * *

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - “Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara”.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-29492-11-14-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje Materiale Kancelarie”, me fond limit 49,993,773 (dyzetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH dhe afat zbatimi 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 15.11.2024

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 80 datë 18 Nëntor 2024

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse, si më poshtë:

1. “Infosoft Office” shpk, NIPT J62426002Q

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave:

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **49,293,920** [dyzetë e nëntë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzetë] lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH = **59,152,704** [pesëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e katër] lekë.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “Librari Dyrrahu” shpk, NIPT L91418502J

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave:

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **37,000,000** [tridhjetë e shtatë milionë] lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH = **44,400,000** [dyzetë e katërmijë e katërqind] lekë.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. “Marketing&Distribution” sh.a, NIPT J72124001N

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave:

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **48,438,000** [dyzetë e tetë milionë e katërqind e tridhjetë e tetë mijë] lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH = **58,125,600** [pesëdhjetë e tetë milionë e njëqind e njëzetë e pesë mijë e gjashtëqind] lekë.

4. “Office Center” shpk NIPT K41425042N

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave:

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **42,316,300** [Dyzetë e dy mijë e treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind] lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH = **50,779,560** [pesëdhjetë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë e pesëqind e gjashtëdhjetë] lekë.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “Librari Dyrrahu” shpk, NIPT L91418502J

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

1. Në pikën **2.3.6**, “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

“Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë skedën teknike të çertifikuar nga prodhuesi i mallit, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike për produktet: **Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3**, si dhe katalogët ose fragmentët e katalogëve të prodhuesit/eve /distributorit/ve për artikujt me numër rendor si vijon: Rendor **1,5, 6, 8, 16, 20, 30, 50, 71**. Skeda teknike dhe katalogët ose fragmentët e katalogëve duhet të paraqiten në gjuhën/gjuhët e kërkuara në DST”.

Sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në shtojcën Nr.6 të dokumentave të tenderit është vendosur që për produktin *Letër A4* dhe *Letër A3* duhet që, operatori ekonomik ofertues të paraqesë SSH EN ISO 9706:1994 ose ekuivalenti i tij, që plotëson kushtet për ruajtjen e saj për një kohë të gjatë në arkivë. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet mungesa e kësaj certifikate në dokumentat e dorëzuara në SPE nga ana e operatorit ekonomik.

Gjithashtu, operatori ekonomik, në zbatim të kriterit **2.3.6** duhet të paraqiste në dokumentat e dorëzuara në SPE, katalogët ose fragmente katalogësh të prodhuesit/eve, distributorit/eve për artikujt me numër rendor si vijon: Rendor **1, 5, 6, 8, 16, 20, 30, 50, 71**. Rezulton se në lidhje me përmbushjen e kësaj pike ofertuesi, ka paraqitur dokumentin e emërtuar “Katalog Bashkia Tiranë.pdf”, i cili është një katalog i hartuar nga ana e vetë operatorit ekonomik, ku për produktet e sipërpërmendura nuk bëhet lidhja e ofertuesit me prodhuesit ose distributorët e tyre. KVO arrin në konkluzionin se oferta teknike e paraqitur nga ky operator ekonomik lë vend për interpretim dhe konfuzion pasi në rast se ky prodhues do t’i plotësonte kërkesat teknike atëherë do të mund t’i paraqiste ato nëpërmjet një katalogu të saktë dhe jo me anë të një table ku për secilën kërkesë deklarohet që e plotëson. Autoriteti kontraktor ka kërkuar paraqitjen e katalogut për të verifikuar te gjitha detajet teknike më të rëndësishme për këto artikuj specifike dhe për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të kishte paraqitur një katalog të saktë.

Sa më sipër, KVO konstaton se, operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” shpk nuk plotëson pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim.

2. Operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” shpk nuk arrin të përmbushë kriterin nr. **2.3.7** të “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit, ku autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

“**2.3.7 Operatorët ekonomikë ofertues në këtë procedurë duhet që ditën dhe orën e hapjes së ofertave, të paraqesin mostra për artikujt me nr rendor: Rendor 2, 3, 14, 29, 34, 41, 48, 55, 69, 86, 91, 100.**

Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim.

Shënim: Numrat rendorë i referohen numrave të artikujve sipas tabelës në shtojcën 7 “Formulari i sasisë dhe grafiku i lëvrimit”.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.

Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në DST”.

Nga analizimi dhe verifikimi i mostrave të dorëzuara ditën dhe orën e hapjes së ofertave nga ana e operatorit ekonomik, rezulton se:

- Mostra me numër rendor nr. 55 “Mbajtëse kancelarie me aksesore me përmasa 25x16x6cm. Me ndarje dhe mbajtëse për fletëpalosje; Mbajtëse kancelarie me mjete me përmasa 25x16x6cm, me disa ndarje të ketë vend për bllok stick note 76x76mm, skoc 19mmx33mm, 4 shenjues me firmë, lapsa, stilolapsa, kapëse aktesh” nuk është sipas specifikimeve teknike të publikuara në DST, në

lidhje me përmasat e përcaktuara, pasi mostra e paraqitur nga ofertuesi pas matjeve të bëra është me përmasat 24x28x8cm. Gjithashtu, shtojmë se, mostra e paraqitur nuk ka vend për shenjues.

- Mostra me numër rendor nr. 69 "USB (32GB), 3.0, 3.2: Me fingerprint që lejon akses deri në 10 shenja gishtash, të instalohet lehtësisht pa pasur nevojë për program software. Të ketë sistemin 256-bit AES për mbrojtje sa më të sigurt të të dhënave. Minimumi 3 vjet garanci. Të jetë për sistem operativ Windows" nuk është sipas specifikimeve teknike, pasi mostra e dorëzuar nga ofertuesi nuk është me sistem mbrojtje të sigurisë së të dhënave, si dhe nuk ka aksesueshmërinë në fingerprint me 10 shenja gishtash.
- Mostra me numër rendor nr. 86 "Makinë grirëse letre (të grijë credit card & paper clips); Makinë grirëse automatike me rrota lëvizëse për lehtësi në transportim, me kosh 115L që mban deri 1100 fletë. Makina grin tela, CD, karta në të njëjtën kohë. Me prerje kryq 4x40mm, teknologji anti ndotje nga boja e letrës, me panel kontrolli dhe kod sigurie. Të jetë i përcaktuar niveli sa më i ulët i zhurmës <60Db. Me sistem fikje pas disa minuta mospërdorimi. Të ketë garanci të paktën dy vjecare si dhe 20 vite + për thikat. Autorizim distributori ose prodhues dhe garanci", nuk është sipas specifikimeve teknike në lidhje me koshin, i cili duhet të mbajë deri në 115L. Mostra nuk përmbush specifikimin teknike: prerja e grirjes nuk është 4x40mm.
- Mostra me numër rendor nr. 91 "Tabelë magnetike xhami MIN 120x180: Sipërfaqe magnetike prej xhami sigurie të kalitur me ultra-fshirje me rezistencën më të lartë ndaj njollave të bojës, shenjave të stilolapsit dhe gërvishtjeve. Me përmasa 1200*1800. Dizajn bashkëkohor elegant, pa kornizë që maksimizon hapësirën e shkrimit në tabelën e bardhë. Pivoti horizontal ka nevojë për më pak hapësirë për t'u rrotulluar. Rrotullat të lejojnë manovrim më të lehtë. Pajisur me tabaka stilolapsi poshtë tabelës" nuk është sipas specifikimeve teknike në lidhje me përmasat e përcaktuara, pasi mostra e paraqitur është me përmasat 24x18x8cm, si dhe tabela nuk është magnetike xhami por është whiteboard e thjeshtë, duke bërë që të gjitha specifikimet të mos përmbushen përsa kohë mostra është whiteboard e thjeshtë.

KVO gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin dhe mostrat e dorëzuara duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave, dokumentacionit provues dhe mostrave në rastet kur ky është një kriter kualifikues, në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

Referuar sa më sipër argumentuar, pas shqyrtimit të dokumentacionit ligjor, teknik dhe fizik, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konkludon se oferta e Operatorit ekonomik "Librari Dyrrahu" SHPK, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë të pavlefshme**.

2. "Office Center" shpk NIPT K41425042N

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

1. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën **2.3.1** të “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit, ku autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatorët ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet**, përkatësisht 19.997.509 lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatorët ekonomik “**Office Center**” shpk ka paraqitur në SPE dokumentacion lidhur me përmbushjen e këtij kriteri, **tre** fatura tatimore të shitjes, përkatësisht Fatura me Numri i faturës: 1657/2024, me vlerë 430,230 lekë pa tvsh, Faturën me Numri i faturës: 1657/2024, me vlerë totale të faturës 449.976,05 leke pa tvsh, Faturën me Numri i faturës: 25/2024, me vlerë totale të Faturës 678,000 lekë pa tvsh, **të cilat përbëjnë në total shumën 1.558.206,05 lekë pa tvsh.**

Për sa me sipër, KVO vlerëson se nuk përmbush kushtin për kualifikim për pikën 2.3.1 të Kapacitetit teknik, pasi referuar vlerës minimale që duhen të përmbushin OE pjesëmarrës për të provuar përvojën e mëparshme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **duhet të jëtë në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, përkatësisht 19.997.509 lekë pa tvsh.**

2. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën **2.3.2** të “*Kapaciteti teknik*”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit, ku autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikatat ose ekuivalente të tyre të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

b) Standardin ISO 14001:2015 ose ekuivalent (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të mjedisit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme), dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

c) Standartin ISO 45001:2018 ose ekuivalent (e përditësuar) për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme), dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

***Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatat ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

Për sa me sipër, KVO vlerëson se nuk përmbush kushtin për kualifikim për pikën 2.3.2 të Kapacitetit teknik, pasi nuk ka paraqitur ISO: b) Standardin ISO 14001:2015 ose ekuivalent dhe c) Standartin ISO 45001:2018 ose ekuivalent.

3. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.4 të “Kapaciteti teknik”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit, ku autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të provojë se disponon minimalisht 3 (tre) makina tip ATP (Automjet për Transport të Përzier) në pronësi, me kontratë qiraje ose forma të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, me afat kohëzgjatje për të gjithë kohën e vazhdimësisë së kontratës.

Për këtë duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, sipas legjislacionit në fuqi. Mjeti duhet të jetë i pajisur me dokumentacion përkatës sipas legjislacionit në fuqi (çertifikatë pronësie, leje qarkullimi, siguracion mjeti dhe çertifikatë e kontrollit teknik të mjetit/ SGS)”.
Shënim: Kriteri 2.3.4 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.9. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese. Këto dokumenta duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për sa me sipër, KVO vlerëson se nuk përmbush kushtin për kualifikim për pikën 2.3.4 të Kapacitetit teknik, pasi nuk ka paraqitur plotësuar në formularin e vetëdeklarimit të SEKSIONIT B, lidhur me disponimin e makinerive të nevojshme, të kërkuara në pikën 2.3.4 I cili konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.9.

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nëse, po, numri i punonjësve: <hr/> Profili i punonjësve 14 (Katërmbdhjete) <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: <hr/>

4. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.5 të “Kapaciteti teknik”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit, ku autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, për mallrat: **Letër për fotokopje A4 dhe Letër për fotokopje A3**. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të Prodhuesit/ Distributorit të Autorizuar si telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet e dokumentuar lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit për mjetet e ofruara.

Shënim: Autorizimi duhet të paraqitet në gjuhën/gjuhët e përcaktuara në DST.

Për sa me sipër, KVO vlerëson se nuk përmbush kushtin për kualifikim për pikën 2.3.5 të Kapacitetit

teknik, pasi nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, për mallrat: **Letër për fotokopje A4 dhe Letër për fotokopje A3.**

5. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.6 të “**Kapaciteti teknik**”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit, ku autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

2.3.6 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë skedën teknike të çertifikuar nga prodhuesi i mallit, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike për produktet: **Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3,** si dhe katalogët ose fragmentët e katalogëve të prodhuesit/eve /distributorit/ve për artikujt me numër rendor si vijon: Rendor **1,5, 6, 8, 16, 20, 30, 50, 71.** Skeda teknike dhe katalogët ose fragmentët e katalogëve duhet të paraqiten në gjuhën/gjuhët e kërkuara në DST.

Shënim: Numrat rendorë i referohen numrave të artikujve sipas tabelës në shtojcën 7 “Formulari i sasisë dhe grafiku i lëvrimit”.

Fragmentët e katalogëve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë e një katalogu, si dhe cilit katalog dhe prodhues i përkasin.

Për sa me sipër, KVO vlerëson se nuk përmbush kushtin për kualifikim për pikën 2.3.6 të Kapacitetit teknik, pasi nuk ka paraqitur skedën teknike të çertifikuar nga prodhuesi i mallit, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike për produktet: **Letër fotokopje A4, Letër fotokopje A3,** si dhe katalogët ose fragmentët e katalogëve të prodhuesit/eve /distributorit/ve për artikujt me numër rendor si vijon: Rendor **1,5, 6, 8, 16, 20, 30, 50, 71.**

6. Operatori Ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.7 të “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit, ku autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

*“2.3.7 Operatorët ekonomikë ofertues në këtë procedurë duhet që ditën dhe orën e hapjes së ofertave, të paraqesin mostra për artikujt me nr rendor: Rendor **2, 3, 14, 29, 34, 41, 48, 55, 69, 86, 91, 100.**”*

Mosparaqitja e mostrave është kusht për skualifikim.

Shënim: Numrat rendorë i referohen numrave të artikujve sipas tabelës në shtojcën 7 “Formulari i sasisë dhe grafiku i lëvrimit”.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.

Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në DST”.

Rezulton se, nga procesverbali i mbajtur nga ana e KVO për paraqitjen e mostrave nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë, ditën dhe orën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik “Office Center” shpk nuk është paraqitur për dorëzimin e mostrave të kërkuara për artikuj si më sipër të përmendur.

7. Komisioni i vlerësimit të ofertave konstaton si më poshtë:

1. Në pikën 2, të shtojcës 7, “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

[...]

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Në seksionin 3 “*Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike*” pika 3.1 “*Sigurimi i ofertës*”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se se prokurimi me vlerë të vogël).

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është: **999,875** (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë |

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 _____ (shuma, monedha)

Loti 2 _____ (shuma monedha)

3.1.2 Autoriteti/Enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor **Kodi Institucionit: 2101001 dhe Llogaria ekonomike: 4662102.**

3.1.3 Autoriteti/Enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

- i. garancisë bankare **X**
ose
- ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente **X**

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 250 (dyqind e pesëdhjetë) ditë

Gjithashtu, referuar DST, Udhëzime për Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, pika B. PËRGATITJA E OFERTAVE, nën-pika 9/1 Periudha e vlefshmërisë së Ofertës, citohet shprehimisht:

1. Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontratës pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.

2. Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njërin nga format e mëposhtme:

- a) Pagesa nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor;
- b) Garanci bankare;
- c) Garanci sigurimi.

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik **“Office Center” shpk** në përmbushje të kriterit sa më sipër nuk ka dorëzuar *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.*

Për sa më sipër, Operatori ekonomik **“Office Center” shpk** nuk plotëson pikën 1.b të Kriterëve të Veçanta për kualifikim ku thuhet se Ofertuesi duhet të paraqesë: *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Sa më sipër, KVO konkludon njëzëri se Operatori Ekonomik **“Office Center” shpk** nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e shpallur **ofertë te pavlefshme.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i sukseshëm:

1. “Infosoft Office” shpk

NIPT J62426002Q

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Adresa: Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri, Tel: +355 42 256 799

Vlera/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave:

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **49,293,920** [dyzetë e nëntë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzetë] lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH = **59,152,704** [pesëdhjetë e nëntë milionë e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e katër] lekë.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Totali i pikëve të marra _____

2. “Marketing&Distribution” sh.a, NIPT J72124001N

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave:

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **48,438,000** [dyzetë e tetë milionë e katërqind e tridhjetë e tetë mijë] lekë.

Çmimi total i ofertës me TVSH = **58,125,600** [pesëdhjetë e tetë milionë e njëqind e njëzetë e pesë mijë e gjashtëqind] lekë.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Totali i pikëve të marra _____

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Zëvendëskryetar / Person i autorizuar